

## Nxitja e proceseve këshillimore

KESE-ja nxit dhe mbështet zhvillimin e Këshillave Ekonomikë dhe Socialë ose të institucioneve të ngjashme në vendet e rajonit.

KESE-ja mbështet vazhdimisht përforsimin e dialogut social dhe atij civil si në opinionet e veta, ashtu edhe nëpërmjet pjesëmarrjes së anëtarëve të vet në konferenca dhe ngjarje.

## Kontaktet e rregullta

Anëtarët e KESE-së marrin pjesë në konferenca ose ngjarje të ndryshme që kanë të bëjnë me Ballkanin Perëndimor, të organizuara në Bruksel ose në rajon.

Ata takojnë gjithashtu përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, në kuadër të vizitave studimore të organizuara në Bruksel ose të programeve të drejtuara nga institucionet e BE-së si Programi i Vizitorëve të BE-së.



Komiteti Ekonomik  
dhe Social Evropian

Rue Belliard/Belliardstraat 99  
1040 Bruxelles/Brussel  
BELGIQUE/BELGIË

Published by: "Visits and Publications" Unit  
EESC-2022-59-SQ

[www.eesc.europa.eu](http://www.eesc.europa.eu)

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi të kontaktoni adresën:  
[balkans@eesc.europa.eu](mailto:balkans@eesc.europa.eu)

Ose vizitoni faqet tona të internetit:  
<http://www.eesc.europa.eu/en/tags/western-balkans>

 @EESC\_REX #EESC\_WB

© Bashkimi Evropian, 2022  
Materiali mund të riprodhohet me kusht të përmendet burimi i tij.  
Për përdorimin ose riprodhimin e fotografive/ilustrimeve leja i duhet kërkuar drejtpërdrejt pronarit/pronarëve të të drejtave të autorit:  
© Shutterstock: america365



Print  
QE-09-22-476-SQ-C  
ISBN 978-92-830-5739-0  
doi:10.2864/912303

Online  
QE-09-22-476-SQ-N  
ISBN 978-92-830-5735-2  
doi:10.2864/281477

SQ



# KESE-ja dhe Ballkani Perëndimor

REX  
Marrëdhëniet  
e jashtme



Komiteti Ekonomik  
dhe Social Evropian

# KESE-JA DHE BALLKANI PERËNDIMOR: QASJE NË DY NIVELE

Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian (KESE) ka zhvilluar një qasje të dyfishtë, rajonale dhe dypalëshe për marrëdhëniet e tij me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të Ballkanit Perëndimor. Të dy qasjet lidhen nga objektivat e përbashkëta globale, të cilat janë:

- dhënia e kontributit për konsolidimin e demokracisë dhe për anëtarësimin e ardhshëm në BE;
- përkrahja e dialogut civil dhe social:
  - nëpërmjet zhvillimit të një kulture dialogu mes autoriteteve dhe OSHC-ve, si dhe midis vetë OSHC-ve;
  - nëpërmjet krijimit të strukturave institucionale transparente dhe të efektshme për dialog civil dhe social;
  - nëpërmjet nxitjes së krijimit të mjediseve të përshtatshme ligjore për veprimtaritë e OSHC-ve;
- fuqizimi i rrjeteve të shoqërisë civile;
- rritja e shkëmbimit të përvojave dhe të praktikave më të mira.

## Qasja Rajonale

### Opinionet

KESE ka përpunuar dhe miratuar një sërë opinionesh për tema me interes rajonal ku përfshihen strategjia për zgjerimin e BE-së, çështjet gjinore specifike për rajonin, Agjenda e Gjellbër dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kohezioni ekonomik dhe shoqëror i Ballkanit Perëndimor, instrumentet financiare të para-anëtarësimin, transporti, punësimi dhe politikat për energjinë etj. Procesi i hartimit mundësoi përforsimin e bashkëpunimit rajonal në nivelin e shoqërisë civile me anë të konsultimeve dhe dëgjësive.

### Grupi i Kontaktit për Ballkanin Perëndimor

Grupi i kontaktit për Ballkanin Perëndimor - një organ i përhershëm i brendshëm i krijuar nga KESE-ja në vitin 2004 - është instrumenti kryesor për bashkërendimin e veprimtarive të KESE-së në Ballkanin Perëndimor. Roli i Grupit të Kontaktit është edhe të mbajë nën vëzhgim ndryshimet në

situatën politike, ekonomike dhe sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në marrëdhëniet midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, Grupi i Kontaktit nxit bashkëpunimin midis KESE-së dhe shoqërisë civile të Ballkanit Perëndimor.

### Forumi i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor

Forumi është pjesë e punës së Grupit të Kontaktit. Duke qenë se organizohet çdo dy vjet prej vitit 2006, ai ofron mundësi për shkëmbimin e mendimeve për gjendjen aktuale në shoqërinë civile në rajon, për nevojat dhe zhvillimin e saj të ardhshëm. Forumi bën bashkë pjesëmarrës nga vendet e Ballkanit Perëndimor, anëtarë të KESE-së, përfaqësues të Këshillit Ekonomik dhe Social nëpër shtete dhe të institucioneve të ngjashme, organizata ndërkombëtare shoqërore dhe profesionale (punëdhënës, sindikata, fermerë, konsumatorë), OJQ-të, përfaqësues të institucioneve të BE-së dhe diplomatë. Pjesëmarrësit miratojnë përfundime që u drejtohen autoriteteve dhe institucioneve evropiane.

Forumi i 8-të, i organizuar më 30 shtator dhe 1 tetor 2021 në Shkup, u mundësoi pjesëmarrësve të diskutojnë çështje si perspektiva e marrëdhënieve midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, roli i organizatave të shoqërisë civile në rimëkëmbjen pas COVID-19, zhvillimi i qëndrueshëm dhe zbatimi i Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor si dhe gjendja e dialogut social dhe si të mundësohet hapësira civile në Ballkanin Perëndimor. Ndër rekomandimet e shumta të miratuara nga pjesëmarrësit, mund të nënvizohet thirrja drejtuar partnerëve socialë dhe organizatave të shoqërisë civile të luajnë rol aktiv në procesin e zgjerimit, duke kapërcyer kështu hendekun midis politikës dhe njerëzve.

### Qasja dypalëshe

KESE gjithashtu punon në baza dypalëshe përmes hartimit të opinionëve dhe krijimit të Komiteteve të Përbashkëta Këshilluese (KPK).

### Opinionet

Si organ këshillimor për institucionet e BE-së, një nga funksionet thelbësore të KESE-së është hartimi i opinionëve për një sërë politikash të BE-së. KESE-ja nxori opinionë për rolin e shoqërisë civile në çdo vend të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë palë të ndryshme të interesuara në përpunimin e opinionëve.

## Komitetet e Përbashkëta Këshillimore të Shoqërisë Civile

KESE-ja është gjithashtu e përfshirë në procesin e anëtarësimin në BE nëpërmjet themelimit të Komiteteve të Përbashkëta Këshillimore të Shoqërisë Civile (KPK). Ato plotësojnë kornizën institucionale të BE-së për secilën Marrëveshje Stabilizim-Asociimi (MSA) mes BE-së dhe vendit të rajonit. Kjo gjë u mundëson organizatave të shoqërisë civile, si nga ana e BE-së ashtu dhe nga ana e vendit përkatës, të vëzhgojnë procesin e anëtarësimin pasi të kenë nisur negociatat e vendit për anëtarësim. Kjo është një platformë dialogu për diskutimin e çështjeve me interes të përbashkët nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Gjithashtu i përgatit përfaqësuesit e shoqërisë civile për t'iu bashkuar KESE-së.

KPK-ja BE-Mali i Zi dhe KPK-ja BE-Serbi janë krijuar dhe mbajnë takime të rregullta. Shpresojmë të krijojmë shumë shpejt KPK-në BE-Maqedoni e Veriut dhe KPK-në BE-Shqipëri.

## Bashkëpunimi Ndërinstitucional

Me qëllim që të ketë qasje gjithëpërfshirëse ndaj rajonit, KESE-ja, nëpërmjet Grupit të Kontaktit, mban marrëdhënie të forta me institucionet dhe agjencitë e BE-së (Komisionin Evropian, Parlamentin Evropian, Këshillin e BE-së, Komitetin e Rajoneve, Fondacionin Evropian për Trajnim) si dhe me organizata aktive ndërkombëtare në Ballkanin Perëndimor si Organizata Ndërkombëtare e Punës, OSBE-ja dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal.

Institucionet e BE-së mund t'i kërkojnë KESE-së të hartojë opinion shpjegues për ndonjë temë specifike dhe të kontribuojë në përcaktimin e politikave ose programeve të BE-së. KESE-ja mundet dhe shpesh jep me nismën e vet opinionë për çështje me interes të veçantë për shoqërinë civile të organizuar.

Gjithashtu, bashkëpunimi me Delegacionet e Bashkimit Evropian në vendet e rajonit, dëshmoi të ishte instrument i vlefshëm në nxitjen dhe zhvillimin e dialogut me organizatat e shoqërisë civile.